



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ndërtim dhe mirëmbajtje e faqes Web të Universitetit të mjekësisë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbimet e projektimit të faqeve për world wide web (www) - 72413000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.569.444,44 (një milion e peseqind e gjashtëdhjetë e nente mijë e katerqind e dyzet e kater presje dyzet e kater) **Leke, pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë objekt veprimtarie ushtrim aktiviteti në fushën e teknologjisë së informacionit /ndërtim dhe mirëmbajtje faqe web, e provuar kjo me ekstraktin QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, ku parashikohet se: " 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.", nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet se: "4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;...".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë certifikimet e mëposhtme ISO:

- ISO 9001:2015 – Sistemi Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente
- ISO/IEC 20000-1:2011 – Sistemi Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit ose ekuivalente
- ISO/IEC 27001:2013 - Sistemi Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ose ekuivalente

Certifikimet duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe 79, të LPP ku parashikohet se: ”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar: ”1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

- ISO 9001:2015 – Sistemi Menaxhimit të Cilësisë të vlefshme

Me anën e këtij kriteri (standartit ISO 9001-2015), synohet që të njihet aftësia e operatorit për të ofruar punë që plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore sipas standardeve më të larta. Ky standart u vendos në bazë të nenit 79, pika 1 e tij, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, e nenit 41, pika 6 dhe 44, pikës 3 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kriter në përputhje me natyrën e objektit të kontratës. Autoriteti kontraktor vlerëson këtë kriter si të nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës. Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet nderkombetare të vendosura në përputhje me legjisacionin nderkombetare që e rregullon këtë fushë, për të garantuar mallra/shërbime me cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike pjesë e dokumentave të tenderit, shume i dobishëm për këtë projekt, si dhe menaxhimin e shërbimit të teknologjisë së informacionit për realizimin e këtij projekti. Duke përdorur ISO 9001:2015, siguron që operatori ekonomik ofron në mënyrë të vazhdueshme produkte dhe shërbime me cilësi të lartë, efikas, redukton gabimet dhe ruan një standard të lartë të ofrimit të shërbimit.

- ISO/IEC 20000-1:2011 – Sistemi Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit të vlefshme

ISO/IEC 20000-1:2011 është një standard i sistemit të menaxhimit të shërbimit. Specifikon kërkesat për ofruesin e shërbimit për të planifikuar, krijuar, zbatuar, operuar, monitoruar, rishikuar, mirëmbajë dhe përmirësojë një SMS. Kërkesat përfshijnë projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e dakorduara të shërbimit.

- ISO/IEC 27001:2013 - Sistemi Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit të vlefshme

ISO/IEC 27001:2013 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit brenda kontekstit të organizatës.

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë të paktën 2 punonjës të tij me eksperiencë në:

- a. Dizenjim dhe administrim baza të dhënash (psh, MySQL, MS SQL, ORACLE etj ose ekuivalente)
- b. Zhvillim aplikacionesh web në platforma të ndryshme.
- c. Menaxhim dhe konfigurim IIS, Apache, Web Server, Web Services ose ekuivalente
- d. Programim në JavaScript, Php, Go-Lang ose ekuivalente
- e. Menaxhim dhe implementim aplikacionesh web dhe website-sh.

Për sa më sipër ofertuesit duhet të paraqesin: kontratat e punes se punonjesve, cv dhe diploma apo certifikime te vlefshme.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e hartimit të dokumentave/ specialisti i fushes, nisur nga natyra specifike që ka kjo lloj kontrate bazuar specifikimeve teknike , grafikun e realizimit te shërbimit , gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim duhet të jenë dhe dëshmitë për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, ne menyre qe t'i shërbejne autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Duke pasur parasysh natyrën komplekse te projektit dhe hallkat ne te cilat ai do te kaloje, ekipi qe do te merret me implementimin e tij duhet te punoje sipas nje metodologjie e cila te siguroje produkte ne faza te shkurtra te perfunduara dhe te testuara. Gjithashtu, metodologjia duhet te ofroje implementim fleksibel duke marre ne konsiderate nevojat gjithmone ne rritje dhe ndryshimet ne procedurat e perfshira.

Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik, ku parashikohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.... Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ...b) një listë të personelit

kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës...”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë minimalisht këto çertifikime:

- *Certifikatë në: Web Applications dhe Specialist Web Developer ose ekuivalente*
- *Certifikatë në: Universal Windows platform ose ekuivalente*
- *Certifikatë në: App builder ose ekuivalente*
- *Certifikatë në: Database Fundamentals ose ekuivalente*

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në nenet 77 dhe 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ”*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit. 4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion. 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor, si dhe bazuar në relacionin për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, përgatitur nga grupi i punës për studimin e tregut dhe përgatitjen e specifikimeve teknike.*

Operatori duhet të deklarojë se merr përsipër me shpenzimet e veta hostimin e faqes web për një vit nga momenti i marrjes në dorëzim të saj.

NJËSIA E PROKURIMIT: